



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/1220**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE "Naim Shuki B.", kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-se - Ritender" me numër të prokurimit; 616-24-10217-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës se Prishtinës, më 27/02/2025, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Naim Shuki B.I", me nr. 2024/1220, e datës 16/12/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-se - Ritender" me numër të prokurimit;616-24-10217-1-2-1, (AK) - Komuna Prishtinës.
2. Vërtetohet "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues", AK-Komuna e Prishtinës, i datën 25.11.2024, lidhur me anulimin e aktivitetit prokurimit me të dhënat si në pikën 1.(një) të vendimit.
3. Konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues OE" "Naim Shuki B.I", bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ,ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.09.2024 Kuvendi i Komunës se Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-se - Ritender" me numër të prokurimit: 616-24-10217-1-2-1.

Ndërsa me datë 25.11.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit sepse asnjë oferte e dorëzuar nuk është e përgjegjshme.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 80,000.00 Euro.

Me 26.11.2024 OE Naim Shuki B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.12.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Naim Shuki B.I., me nr. 1220/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-se - Ritender” me numër të prokurimit 616-24-10217-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Naim Shuki B.I. janë parashtruar si në vijim:

Me datë 25.11.2024, kemi pranuar në e-prokurim Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është bërë anulimi i procedurës, duke u bazuar në faktin se mostrat e dorëzuara nuk plotësojnë kërkesat e Ankës 1 të specifikimeve teknike të detyrueshme, gjë që nuk është e vërtetë.

Pretendimi i AK-së është se mostrat nuk kanë bazë ligjore, ndërkohë që mostrat e OE Naim Shuki 131 plotësojnë të gjitha kërkesat e AK-së, sipas kërkesës që ka bërë në e-prokurim para hapjes së ofertave (data 07.10.2024). Në e-prokurim është ngarkuar dosja me përshkrimin e çmimeve, të korigjuara për artikuj dimërorë.

Po ashtu, në asnjë pozicion nuk figurojnë standardet ISO për shirita, ngjyrën e astarit, pjesën e brendshme të xhaketës (përfshirë zinxhirët apo sustat që përdoren për heqjen e xhaketës). Ngjyra e dukshmërisë dhe këpucët dimërorë nuk janë të përfshira në asnjë dokument të ngarkuar në e-prokurim dhe nuk ka bazë ligjore për eliminimin e OE Naim Shuki BI.

Në Aneksin 1 të specifikimeve teknike të detyrueshme, nuk ka asnjë specifikim për kërkesat e përmendura më lart, të cilat ishin arsyeja për anulimin e procedurës ndaj OE Naim Shuki BI. Si prodhues, ne kemi mundësinë të plotësojmë të gjitha kërkesat e mësipërme, nëse këto ishin kërkuar para hapjes së ofertave.

Në anën tjetër, AK ka publikuar kriteret për uniformat në e-prokurim pasi ka marrë një vendim të paligjshëm për anulimin e procedurës dhe eliminimin e OE Naim Shuki BI. Specifikimet teknike për uniformat janë publikuar me datë 26.11.2024, në orën 14:50, ndërkohë që Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës është marrë më datë 25.11.2024, në orën

10:59. Hapja e ofertave dhe dorëzimi i mostravë janë kryer më datë 24.10.2024, në orën 08:35.

Deklarojmë se të gjitha mostrat e dorëzuara nga OE Naim Shuki 131 plotësojnë kërkesat ligjore të AK-së për uniformat, siç janë të përcaktuara në e-prokurim para hapjes së ofertave.

1. Xhakete dimërore me jakne të brendshme 2. Pantallona dimërore 3. Duks 4. Këpucë dimërore

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Operatori Ekonomik, Naim Shuki B.1, për mostrat e ofruara nuk plotëson kriteret si më poshtë: Xhaketa me 2 shirita reflektues sipas standardit UNI EN ISO 20471:2017, Astari i brendshëm i xhaketes nga rrjeta 100%, ngjyra jo e kuqe, nuk hiqet me zinxhir pjesa e brendshme, tek pantallonat xhepat nuk kanë mbyllje me zinxhirë. Duksinë po ashtu, ngjyra nuk është në përputhje me specifikat dhe një xhep me zinxhir në anën e lartë, si dhe këpucët dimërore nuk janë në harmoni me specifikat, ndërsa të gjitha të tjerat jo. Ndërkaq, mostrat që ka ofruar OE:

Sa i përket pretendimit se arsyet eliminues nuk janë të përcaktuara me specifika teknike, ky pretendim nuk qëndron pasi që secila nga arsyet eliminues derivon në mënyrë konkrete nga specifikat teknike të detyrueshme. Si shembull, kërkesa që xhaketa me 2 shirita reflektues duhet të jetë sipas UNI EN ISO 20471:2017 është në faqe 2 të ST, ku thuhet se "Xhaketa duhet të ketë dy shirita reflektues sipas standardit UNI EN ISO 20471:2017". Po ashtu, kërkesa që astari i brendshëm të jetë 100% nga rrjeta është gjithashtu në faqe 2 të ST, ku thuhet se "Astari i brendshëm i xhaketes duhet të jetë nga rrjeta 100% poliamide me peshë  $120 \text{ gr/m}^2 \pm 5\%$ ". Po ashtu, në faqe 2 është edhe kërkesa për ngjyrë të kuqe, ku thuhet "Ngjyra: E kuqe", etj. Pra, të gjitha arsyet eliminues derivon nga ST, prandaj kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar. Sa i përket pretendimit se specifikat teknike janë ngarkuar në eProkurim pas anulimit të aktivitetit, ky pretendim po ashtu nuk qëndron pasi që specifikat teknike janë pjesë e dosjes së tenderit. Në fakt, nuk mund të iniciohet fare aktiviteti i prokurimit pa ST. Mirëpo, për shkak të vëllimit të madh, ato nuk janë ngarkuar në eProkurim në kuadër të DT; AK ka qenë i detyruar ta ngarkojë ndaras. Përndryshe, të gjithë OE të interesuar kanë pasur mundësi që para hapjes së ofertave të kërkojnë qasje në ST. Sidoqoftë, aktiviteti i prokurimit si i tillë është anuluar dhe në mundësinë e parë dhe sipas interesit të njësisë kërkuese, do të ritenderohet, ndërsa të gjithë OE të interesuar mund të dorëzojnë sërish ofertën e tyre në përputhje me të gjitha specifikat teknike të detyrueshme.

Në këtë mënyrë, është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 23/12/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1220/2024, ndërsa me datë

16/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1220 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, të mbetet nëfuqi vendimi I AK-së për anulim të aktivitetet, dhe të njëjtën mund ta ri-tenderojnë.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE Naim Shuki B.I. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/1220 ka vlerësuar si në vijim:

Pas shqyrtimit të detajuar të lëndës së tenderit në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe duke u bazuar në të dhënat në dispozicion, eksperti SHQYRTUES paraqet këtë mendim si në vazhdim:

Vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën e OE "Naim Shuki" B.I:

Eksperti shqyrtues i prokurimit, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, në kontekstin e përgjithshëm të shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës në platformën e-prokurimi, sipas vlerësimit profesional dhe të pavarur në kuptim të nenit 114 të LPP-së, paraqet gjetjet si më poshtë:

Pretendimet ankimore lidhur me mosplotësimin e kërkesave të DT – Kërkesat mbi Specifikacionin Teknik:

Përmes këtij pretendimi, që janë të ndërlidhura me thelbin e pohimeve ankimore, OE ankues ka pretenduar se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në dhe Aneksin 1 të DT-së (shih secilin pretendim të përshkruar më lart, pa nevojë të përshkruhen në detaje sërish).

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimet e lartpërmendura:

Eksperti shqyrtues sqaron se, duke marrë parasysh që pretendimet e lartcekura janë të ndërlidhura me objektin e njëri-tjetrit, është vendosur që të trajtohen dhe shqyrtohen si tërësi, bashkërisht. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe analizimit të shkresave të kësaj lënde të dokumentuara në platformën e-prokurimi, duke u mbështetur në LPP si ligj material dhe rregullat e prokurimit publik (RRPP), eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues për faktin se AK me aktet dhe veprimet e saj ka respektuar nenin 59 të LPP-së, në paragrafin 4, ku thuhet:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

Ndërlidhur me këtë situatë, eksperti shqyrtues vlerëson se veprimet dhe aktet e AK-së janë në përputhshmëri me ligjshmërinë e procesit të prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 të LPP-së, ku thuhet: "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj."

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues për faktin se AK me aktet dhe veprimet e saj ka vepruar në harmoni me LPP-në dhe aktet e tjera nënligjore. Ky pretendim ankimor i OE është i pa-bazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 23/12/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1220/2024, ndërsa me datë 16/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1220 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, të mbetet nëfuqi vendimi I AK-së për anulim të aktivitetet, dhe të njëjtën mund ta ri-tenderojnë.

Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Naim Shuki B.I".Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Naim Shuki B.I", janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik duhet refuzohet si e pabazuar dhe mbet në fuqi, Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 25.11.2024, për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me veshmbathje për nevojat e QMU-se - Ritender" me numër të prokurimit; 616-24-10217-1-2-1, (AK) - Komuna Prishtinës.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/1220, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës të OE "Naim Shuki B.I",vendosi ti konfiskoj tarifën e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

-



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Naim Shuki B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: